

**LIGJI NR. 04/L - 127  
PËR REGJISTRIMIN E BUJQËSISË**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR REGJISTRIMIN E BUJQËSISË**

**KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Ky ligj përcakton përmbajtjen, organizimin dhe zbatimin e Regjistrimit të Bujqësisë në vitin 2013, në tërë territorin e Republikës së Kosovës si:

1.1. krijimin, përbërjen, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të cilat e organizojnë, ndihmojnë dhe kryejnë regjistrimin, periudhën e mbledhjes së të dhënave;

1.2. dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e regjistrimit, procedurën për grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave të regjistrimit;

1.3. mënyrën dhe formën e publikimit dhe shpërndarjes së të dhënave, dhe

1.4. ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave individuale të regjistrimit.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

1. Regjistrimi do të sigurojë informata mbi prodhuesit bujqësorë dhe ekonomitë bujqësore në Kosovë, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor si në vijim:

2. Ekonomitë familjare bujqësore që merren me prodhimtari bujqësore si aktivitet të tyre kryesor ose dytësor.

3. Prodhuesit bujqësorë, ndërmarrjet bujqësore, kooperativat bujqësore dhe ndërmarrësit dhe format tjera të organizimit me statusin e personit juridik të cilët janë të regjistruar dhe merren kryesisht me prodhimtari bujqësore, dhe ndërmarrjet, institucionet dhe personat tjerë juridik, të regjistruar në një tjetër aktivitet jo bujqësorë, që kanë të organizuara degë ose njësi të tjera organizative ku kryhet prodhimtaria bujqësore.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Prodhuesi bujqësorë** - njësi prodhuese e pavarur teknike dhe ekonomike me një menaxhim të vetëm, në të cilën një ndërmarrje bujqësore, kooperativë bujqësore, institucion apo person tjetër juridik, ndërmarrës ose ekonomi familjare merret me veprimtari bujqësore si aktivitet kryesorë ose dytësorë;

1.2. **Titullari** - grupi i personave ose personi fizik apo juridik në emër të të cilit është prona dhe i cili është ligjërisht dhe ekonomikisht përgjegjës për pronën ;

1.3. **Ekonomi bujqësore** - familje ose grupe të njerëzve që jetojnë së bashku dhe ndajnë shpenzimet jetësore nga të ardhurat e tyre, duke përfshirë personin e vetëm, anëtarët tjerë të përfshirë në prodhimtari bujqësore si aktivitet primar ose sekondar, që kanë një menagjment të vetëm duke përdorur të mirat e përbashkëta siç janë : toka, makineria, ndërtesat, dhe punën e përbashkët;

1.4. **Toka e shfrytëzuar bujqësore** - sipërfaqe e përgjithshme e tokës së punueshme, kullosat e përhershme, bimët shumë vjeçare, kopshtijet që shfrytëzohen nga prodhuesi bujqësorë, pavarësisht nga tipi i posedimit, nëse përdoret si pjesë e tokës së përbashkët;

1.5. **Prodhimtaria bujqësore** - përfshinë prodhimet e kulturave bimore dhe blegtorale;

1.6. **Prodhimet e kulturave bimore** - përfshijnë prodhimtarinë e kulturave lavërtare, pemëtare, perimore, hardhinë e rrushit, bimëve dekorative, bimëve aromatike dhe mjekësore;

1.7. **Blegtoria** - përfshin numrin e kafshëve që janë në prodhim dhe në zotërim të drejtpërdrejtë ose menaxhim apo mbajtje në ditën referente të regjistrimit.

1.8. **Qeveria** - Qeveria e Republikës së Kosovës;

1.9. **MBPZHR** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

1.10. **ASK** - Agjencia e Statistikave të Kosovës.

## **KREU II REGJISTRIMI I EKONOMIVE BUJQËSORE**

### **Neni 4 Regjistrimi**

1. Regjistrimi i ekonomive bujqësore ofron:

1.1. të dhëna për strukturën e ekonomive bujqësore brenda territorit të Republikës së Kosovës, të harmonizuara me standardet e BE-së dhe rekomandimet ndërkombëtare;

1.2. Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë, pushtetit lokal, ekonomive bujqësore, organizatave ekonomike, institucioneve shkencore dhe kulturore, si dhe shoqërisë civile, të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e politikave bujqësore dhe politikave të tjera si dhe për kërkime shkencore;

1.3. themelon bazën e të dhënave me ekonomi bujqësore, regjistrin statistikor të fermave, e cila do të mundësojë zhvillimin e sistemit të integruar statistikor bujqësor në Kosovë në pajtueshmëri me legjislacionin e BE-së.

### **Neni 5 Pyetësorët e regjistrimit dhe dokumentacioni**

1. Dokumentet e regjistrimit të përgatitur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës janë:

1.1. pyetësori kryesor;

1.2. pyetësorët shtesë, nëse është e nevojshme;

1.3. udhëzuesit metodologjike.

2. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave i vërteton, aprovon-miraton pyetësorët dhe dokumentet metodologjike. Para vërtetimit, ai duhet të kërkoj mendimin e Komisionit për Regjistrim të Bujqësisë.

## **Neni 6**

### **Të dhënat e mbledhura gjatë regjistrimit**

1. Të dhënat e mbledhura gjatë regjistrimit do të jenë për:
  - 1.1 ekonomitë familjare bujqësore si emri i pronarit, mbiemri, gjinia, numri identifikues personal, mosha, adresa postare, adresa e email-it, numri i telefonit;
  - 1.2 ndërmarrjet bujqësore si emri dhe adresa postare e vend ndodhjes, numri i regjistrimit të biznesit, adresa e e-mail-it, numri i telefonit - faksit.
2. Për llojet e ekonomive bujqësore janë të dhënat për:
  - 2.1. lokacionin e ekonomisë bujqësore;
  - 2.2. sipërfaqen e tokës në pronësi, sipërfaqja e tokës së marrë dhe dhanë me qira dhe sipërfaqja e përgjithshme e tokës së shfrytëzuar nga ekonomia bujqësore;
  - 2.3. tokën bujqësore të shfrytëzuar për kultura të veçanta;
  - 2.4. blegtorinë sipas llojeve dhe kategorive;
  - 2.5. objektet, makinerinë bujqësore dhe pajisjet.
3. Të dhënat për fuqinë punëtore të ekonomive bujqësore për:
  - 3.1. titullarin dhe anëtarët e familjes që punojnë në fermë si viti i lindjes, gjinia, koha e shpenzuar për punë bujqësore, koha e shpenzuar për punët që lidhen me veprimtari tjetër bujqësore, arsimim, veprimtari tjetër fitimprurëse e personave;
  - 3.2. personat e tjerë që punojnë në ekonomi bujqësore si gjinia, mosha, edukimi dhe koha e shpenzuar për punë bujqësore;
  - 3.3. për personat me punë përkohshme sezonale që punojnë në bujqësi.
4. Të dhënat për shitjen e prodhimeve bujqësore, prodhimeve bujqësore organike, veprimtari tjera fitimprurëse.
5. Të dhënat për metodat e prodhimtarisë bujqësore;
6. Të dhënat për masat e zhvillimit rural;
7. Të dhëna për shfrytëzimin e pyjeve në ekonominë bujqësore.

## **Neni 7**

### **Koha dhe periudhat referuese të regjistrimit**

1. Mbledhja e të dhënave të regjistrimit të bujqësisë realizohet prej 01-20 nëntor 2013.
2. Periudhat referuese janë për:
  - 2.1. shfrytëzimin e tokës, një (1) vit bujqësor, nga data 31 tetor 2012 deri 01 nëntor 2013;
  - 2.2. blegtorinë, me 01 Nëntor 2013;
  - 2.3. fuqinë punëtore, një (1) vit bujqësor, nga 31 tetor 2012 deri 01 nëntor 2013;
  - 2.4. masat e zhvillimit rural, në periudhë prej tre (3) vjetësh, që përfundon më 31 dhjetor 2013.

3. Para zbatimit të regjistrimit kryhet pilot regjistrimi me qëllim që të testohet metodologjia dhe logjistika e regjistrimit. Pilot regjistrimi mbulon deri një përqind (1%) të ekonomive bujqësore të zgjedhura në mënyrë sistematike në të gjitha komunat. Pilot regjistrimi realizohet prej datës 01-15 nëntor 2012.

4. Pas përfundimit të regjistrimit, prej datës 01-15 dhjetor, kryhet anketa pas regjistrimit, e cila bazohet në mostër përfaqësuese të ekonomive bujqësore deri në një përqind (1%) të ekonomive bujqësore. Synimi i anketës pas regjistrimit është të vlerësohet mbulueshmëria e regjistrimit dhe besueshmëria e të dhënave të mbledhura gjatë regjistrimit.

### **Neni 8 Metoda e regjistrimit**

1. Metoda e regjistrimit është metoda tradicionale "**derë-më-derë**", me anë të pyetësorëve të regjistrimit për ekonomi familjare bujqësore në zonat rurale.

2. Ekonomitë familjare bujqësore në zonat urbane dhe rurale anketohen në bazë të listës së përgatitur nga regjistrimi i popullsisë i kryer në Kosovë në vitin 2011 dhe i azhurnuar me burimet administrative dhe statistikore në dispozicion.

3. Ndërmarrjet bujqësore, ndërmarrësit dhe njësi të tjera juridike që kryejnë veprimtari bujqësore do të anketohen në bazë të listës së përgatitur nga regjistri i bizneseve i cili do të azhurnohet me burimet statistikore dhe administrative në dispozicion.

4. Për të gjithë llojet e ekonomive bujqësore zbatohet metoda e intervistimit "**ballë për ballë**".

### **Neni 9 Obligimet**

1. Pronari apo personi i autorizuar i ekonomive bujqësore është i obliguar që gjatë regjistrimit t'u ofrojnë regjistruesve dhe personelit tjetër të autorizuar të regjistrimit të dhënat e kërkuara të plota dhe të sakta.

2. Në rast të mungesës së arsyeshme të dhënat mund të ofrohen nga anëtarët e tjerë të ekonomisë bujqësore sipas rregullave të përcaktuara metodologjike të regjistrimit.

## **KREU III BASHKËPUNIMI, PËRDORIMI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE**

### **Neni 10 Autoriteti Kompetent**

Regjistrimi, organizohet dhe kryhet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në bashkëpunim me institucionet përkatëse të përcaktuara apo të krijuara sipas dispozitave të këtij ligji.

### **Neni 11 Përdorimi i të dhënave administrative**

1. Të dhënat e nevojshme për realizimin e regjistrimit mund të merren nga të gjitha bazat ekzistuese zyrtare të të dhënave dhe bazat tjera administrative të të dhënave, qoftë të sektorit publik apo privat. Personi, me të cilin kanë të bëjnë të dhënat, gjatë intervistimit patjetër, duhet të informohet nga regjistruesi se si janë marrë të dhënat.

2. Pronarët e bazës së të dhënave, duhet t'ia japin Agjencisë së Statistikave të Kosovës të gjitha të dhënat e nevojshme në kohën dhe në mënyrën në të cilën i kërkon të dhënat.

3. Bazë kryesore e të dhënave për përgatitjen e kornizës do të jetë lista e ekonomive familjare me veprimtari bujqësore, e marrë nga Regjistrimi i Popullsisë i realizuar në Kosovë në vitin 2011 dhe regjistri i bizneseve.

**Neni 12**  
**Mbrojtja e të dhënave dhe fshehtësia e tyre**

1. Organet dhe institucionet e përcaktuara në Nenin 14,16 dhe 17 të këtij Ligji, gjatë dhe pas procesit të regjistrimit garantojnë:

1.1. fshehtësinë e plotë të të dhënave individuale të ekonomive bujqësore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, Ligjit Nr 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të dhënave personale;

1.2. parandalimin e qasjes së paautorizuar në qendrën e bazës së të dhënave grupore dhe individuale, ku është bërë ruajtja e tërë kontingjentit të regjistrimit.

2. Të dhënat e mbledhura, grupore apo individuale, janë anonime për palën e tretë dhe si të tilla mund të komunikohen vetëm me autorizimin e fshehtësisë për qëllime të cilat janë në përputhje me qëllimet statistikore të regjistrimit. Marrësi i të dhënave detyrohet për mbrojtjen e fshehtësisë profesionale të të dhënave. Marrësi është i detyruar që të marrë masat e duhura të sigurisë dhe të sigurojë se çfarëdo publikimi i rezultateve statistikore do të jetë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Personeli i angazhuar në procesin e regjistrimit patjetër, duhet t'i ruaj shënimet nga intervistat e regjistrimit si informacion konfidencial dhe është i mbrojtur me Ligj.

**Neni 13**  
**Rezultatet e regjistrimit**

1. Agjencia e Statistikave të Kosovës, duhet të shpallë rezultatet :

1.1. e përkohshme të regjistrimit deri më 28 shkurt 2014;

1.2. detale dhe përfundimtare të regjistrimit në formë elektronike dhe në letër, duke filluar nga 30 shtatori 2014 e tutje.

**KREU IV**  
**KOMISIONI I REGJISTRIMIT TË BUJQËSISË**

**Neni 14**  
**Komisioni**

1. Komisioni i regjistrimit të bujqësisë është trupi më i lartë për mbikëqyrjen e Regjistrimit.

2. Komisioni i Regjistrimit të Bujqësisë, mbikëqyrë përgatitjen dhe organizimin e regjistrimit.

3. Komisioni i Regjistrimit të Bujqësisë përbëhet nga:

3.1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - kryesues;

3.2. Agjencia e Statistikave të Kosovës - zëvendës kryesues;

3.3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

3.4. Ministria e Financave;

3.5. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;

3.6. Ministria e Punëve të Brendshme;

3.7. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;

- 3.8. një (1) përfaqësues nga komuniteti serb;
- 3.9. një (1) përfaqësues nga komunitetet tjera;
- 3.10. një (1) përfaqësues nga Fakulteti i Bujqësisë;
- 3.11. një (1) përfaqësues nga Shoqëria Civile;
- 3.12. një (1) përfaqësues nga Oda Ekonomike e Kosovës, dhe
- 3.13. një (1) përfaqësues nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

4. Mandati i Komisionit të Regjistrimit të Bujqësisë përfundon më 28 shkurt 2014.

5. Pas datës 28 shkurt 2014, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Regjistrimit të Bujqësisë, duhet të transferohen tek Agjencia e Statistikave të Kosovës.

### **Neni 15** **Kompetencat e Komisionit për Regjistrimin e Bujqësisë**

1. Komisioni për regjistrimin e bujqësisë:

- 1.1. mbikëqyrë dhe monitoron përgatitjen dhe zbatimin e regjistrimit;
- 1.2. ndihmon dhe garanton koordinimin e punës lidhur me regjistrimin, ndërmjet ministrive, institucioneve dhe palëve tjera të përfshira në regjistrim ;
- 1.3. jep mendime, propozon rekomandime dhe i nënshkruan me kohë, sipas programit të punës, projekt pyetësorët për regjistrim të përgatitura nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës;
- 1.4. analizon raportet e përgatitura nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës dhe problemet e hasura gjatë procesit të veprimeve të regjistrimit dhe në mënyrë aktive merr pjesë në zgjidhjen e mungesave eventuale, vonesave dhe problemeve tjera;
- 1.5 informon, së bashku me Agjencionin e Statistikave të Kosovës Qeverinë për problemet kryesore që lidhen me veprimet e regjistrimit;
- 1.6. analizon rezultatet e përkohshme të regjistrimit të përgatitura dhe të dorëzuara për shqyrtim nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës;
- 1.7. jep mendimin për planin e përgjithshëm të punës lidhur me aktivitetet për regjistrim, përgatitur nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës;
- 1.8. jep mendime për fushatën publicitare;
- 1.9. rishikon pilot planin e regjistrimit të veprimeve dhe rezultateve të raportuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës si dhe anketën pas regjistrimit;
- 1.10. rishikon planin e tabelimit, përpunimin e të dhënave dhe programin e shpërndarjes së të dhënave;
- 1.11. komisioni mbledhet çdo tre (3) muaj që nga momenti i funksionimit të tij ose me shpesh nëse paraqitet nevoja. Në raste të veçanta anëtarët e komisionit mund të konsultohen për të shprehur pikëpamjet e tyre edhe përmes procedurës së shkruar;
- 1.12. aktivitetet e Sekretarisë Teknike të Komisionit i kryen Agjencioni i Statistikave të Kosovës së bashku me Divizionin e Statistikave të MBPZHR-së.

2. Komisioni për regjistrimin e bujqësisë e përfundon aktivitetin e tij me 28 shkurt 2014.

## **KREU V TË DREJTAT DHE OBLIGIMET**

### **Neni 16 Agjencia e Statistikave të Kosovës**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë:

- 1.1. menaxhon me burimet financiare dhe njerëzore të projektit të regjistrimit;
- 1.2. bashkëpunon me organe dhe institucione tjera dhe koordinon aktivitetet në lidhje me organizimin dhe kryerjen e regjistrimit;
- 1.3. angazhon personelin për projektin e regjistrimit, brenda dhe jashtë Agjencisë së Statistikave dhe i kompenson ata sipas projektit të regjistrimit;
- 1.4. harton programin e punës, definon metodologjinë e regjistrimit ndërkombëtarisht të krahasueshme me përkufizimet uniforme, përzgjedh pajisjet e duhura teknike dhe programet e softuerit, dizajnon pyetësorët, nxjerr udhëzimet dhe vendimet e nevojshme dhe në mënyrë të pavarur menaxhon përgatitjet për realizimin e regjistrimit mbi baza shkencore;
- 1.5. menaxhon procesin e regjistrimit dhe i raporton Komisionit të Regjistrimit të Bujqësisë në lidhje me përdorimin e këtyre burimeve;
- 1.6. përgatitë listën e ekonomive familjare bujqësore me burime statistikore dhe administrative në dispozicion për zonat urbane dhe u'a ofron për azhurnim komisioneve komunale të regjistrimit listën e organizuar sipas qarqeve të regjistrimit, para zbatimit të punës në terren për Regjistrimin e Bujqësisë.
- 1.7. përgatitë listën e ndërmarrjeve bujqësore dhe njësive të tjera ligjore që merren me veprimtari bujqësore, duke shfrytëzuar regjistrin e bizneseve dhe burime tjera statistikore dhe administrative në dispozicion dhe u'a ofron për azhurnim komisioneve komunale të regjistrimit listën e organizuar sipas qarqeve të regjistrimit, para fillimit të punës në terren për regjistrimin e bujqësisë.
- 1.8. organizon punën për dizajnimin dhe shtypjen në letër të pyetësorëve, udhëzimeve metodologjike, hartave të qarqeve regjistruese, pajisjeve të parapara shenjave identifikuese dhe kartelat e identifikimit, shenjat e tjera në kapela, këmisha apo të tjera, llojet e pyetësorëve sipas gjuhëve zyrtare në Kosovë dhe gjuhëve që kanë statusin e gjuhëve zyrtare në bazë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve;
- 1.9. pranon dokumentacionin e plotësuar pas regjistrimit;
- 1.10. përcakton kriteret për përzgjedhjen e regjistruesve, kontrollorëve, mbikëqyrësve, koordinatorëve, përzgjedh koordinatorët, mbikëqyrësit dhe kontrollorët dhe bënë para-përzgjedhjen e regjistruesve;
- 1.11. organizon dhe mbikëqyrë trajnimin profesional dhe metodologjik për anëtarët e komisioneve komunale të regjistrimit, kryen punën në terren në bashkëpunim me komisionet komunale të regjistrimit, duke i regjistruar ekonomitë bujqësore;
- 1.12. ofron mbështetje profesionale dhe metodologjike për komisionet komunale në përgatitjen dhe zbatimin e regjistrimit;
- 1.13. informon autoritetet dhe organet relevante qeveritare për hapat që merren në regjistrim, zhvillon fushatën e informimit të publikut dhe i raporton Komisionit të Regjistrimit të Bujqësisë për zhvillimin e procesit të regjistrimit;

- 1.14. i obligon komisionet komunale të regjistrimit që të marrin masat e nevojshme për zbatimin e procesit të regjistrimit me kohë, me saktësi, cilësi dhe besueshmëri;
- 1.15. dorëzon materialin e regjistrimit komisioneve komunale të regjistrimit;
- 1.16. dizajnon dhe përzgjedh mostrën për pilot regjistrimin;
- 1.17. dizajnon dhe kryen anketën pas regjistrimit;
- 1.18. prezanton dhe shpërndanë rezultatet e përkohshme dhe përfundimtare të regjistrimit.

### **Neni 17** **Komisioni Komunal i Regjistrimit**

1. Komisioni Komunal i Regjistrimit në çdo Komunë e përfaqëson strukturën etnike të popullsisë.
2. Komisioni Komunal i Regjistrimit themelohet së paku gjashtë (6) muaj para ditës së regjistrimit.
3. Komisioni Komunal i Regjistrimit përbëhet nga pesë (5) anëtarë si:
  - 1.1. Kryetari i Komunës;
  - 1.2. dy (2) përfaqësues nga Komuna;
  - 1.3. një (1) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe
  - 1.4. një (1) përfaqësues nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

### **Neni 18** **Detyrat e Komisionit Komunal të regjistrimit**

1. Detyrat e Komisionit Komunal të Regjistrimit janë:
  - 1.1. organizon, realizon dhe kryen projektin e regjistrimit bujqësor në Komunë;
  - 1.2. mbikëqyrë regjistruerit, kontrollorët dhe personelin tjetër të përfshirë në regjistrim dhe siguron funksionimin normal gjatë fazës së regjistrimit si dhe ndërhyrje në rast të pengesave gjatë procesit të regjistrimit;
  - 1.3. azhuron listën e ekonomive familjare bujqësore në zonat urbane dhe listën e njësive juridike;
  - 1.4. ngritë vetëdijen e popullsisë dhe ekonomive familjare bujqësore për rëndësinë e regjistrimit, metodat dhe periudhën e kryerjes së tij, të drejtat dhe detyrat e pjesëmarrësve në Regjistrim dhe për mënyrën në të cilën ata duhet t'i kryejnë ato;
  - 1.5. pranon materialet e regjistrimit nga kontrollorët dhe i kontrollon ato, së bashku me mbikëqyrësit;
  - 1.6. merr pjesë në përgatitjen e rezultateve të para të regjistrimit për Komunën së bashku me mbikëqyrësin, në pajtim me nenin 12 të këtij ligji dhe brenda dhjetë (10) ditëve pas përfundimit të regjistrimit i'a dorëzon rezultatet e para dhe materialet e regjistrimit Agjencisë për Statistika;
  - 1.7. përzgjedh numrin e regjistruerit nga lista e para-përzgjedhur dhe personelin tjetër shtesë, me qëllim që të sigurohet funksionimi normal, i saktë dhe në kohë të regjistrimit;



1.8. sipas udhëzimeve dhe vendimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, merr masat e nevojshme për regjistrimin, bënë përgatitjen dhe kryen Regjistrimin në tërë territorin e Komunës, ofron informata dhe ndihmon personelin e regjistrimit lidhur me vendbanimet;

1.9. në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës i trajnon regjistruesit dhe kontrollorët dhe mbikëqyre punën e tyre;

1.10. në përputhje me udhëzuesin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, i raporton rregullisht asaj lidhur me zhvillimin e procesit të regjistrimit brenda Komunës, përdërisa gjatë periudhës së punës në terren për regjistrim, raporton për çdo ditë;

1.11. siguron lokalet, pranon dhe deponon materialet e regjistrimit në Komunë dhe i dorëzon ato Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

## **KREU VI FUSHATA E INFORMIMIT**

### **Neni 19 Informimi**

1. Regjistrimi, duhet të bëhet publik nëpërmjet komunikatave zyrtare me shkrim, medie dhe fushatës publike gjithëpërfshirëse e cila kryhet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

2. Fushata publike, duhet të fillojë se paku tre (3) muaj para regjistrimit, ndërsa fushata intensive e informimit, duhet të fillojë katër (4) javë para datës së fillimit të regjistrimit.

### **Neni 20 Përpunimi i të dhënave**

1. Agjencia e Statistikave të Kosovës përgatitë Qendrën për përpunimin, futjen dhe ruajtjen e të dhënave në tërë kontingjentin e regjistrimit dhe bënë: kontrollin, kodimin, përpunimin dhe ofrimin e të dhënave personale dhe listën e tabelave dhe tabelimit të të dhënave të regjistrimit.

2. Hapësira e punës për regjistrim, duhet të sigurohet së paku gjashtë (6) muaj para se të bëhet regjistrimi.

### **Neni 21 Personeli i regjistrimit**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit të regjistrimit:

1.1. regjistruesit - pajisen me autorizim zyrtar;

1.2. regjistruesit shkojnë **“derë-më-derë”** në zonën rurale për të intervistuar ekonomitë familjare bujqësore, duke plotësuar me saktësi pyetësorët e regjistrimit. Në zonat urbane intervistohen ekonomitë familjare bujqësore në bazë të listës. Në bazë të listës janë po ashtu edhe intervistat e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve bujqësore, si dhe njësive tjera juridike bujqësore.

1.3. regjistruesit rezervë - pajisen me autorizim zyrtar për regjistrim dhe ata do të angazhohen për të punuar vetëm në mungesë të regjistruesve;

1.4. kontrollorët - pajisen me autorizim zyrtar dhe asistojnë dhe kontrollojnë punën e regjistruesve;

1.5. mbikëqyrësit - kanë për detyrë të asistojnë dhe kontrollojnë punën e kontrollorëve;

1.6. koordinatorët - bëjnë koordinimin midis komisioneve komunale dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës;

1.7. operatorët - fusin të dhënat nga pyetësi në sistemin kompjuterik;

1.8. personeli menaxhues organizon dhe përgatitë informacione, bënë sensibilizimin, logjistikën dhe administron regjistrimin në terren;

1.9. personeli i Agjencisë së Statistikave të Kosovës me ekspertë përgatisin infrastrukturën dhe instrumentet e regjistrimit, planifikimin, trajnimet, mbikëqyrjen, përpunimin, analizimin, tabelimin e të dhënave grupore, prodhimin dhe shpërndarjen e rezultateve të regjistrimit;

1.10. Agjencia e Statistikave të Kosovës, i përcakton kriteret për përzgjedhjen, angazhimin dhe trajnimin e personelit të regjistrimit;

1.11. caktimi i regjistruarëve bëhet nga Komisioni Komunal i Regjistrimit bazuar në para-përzgjedhjen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës;

1.12. caktimi i kontrollorëve dhe i mbikëqyrësve bëhet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës;

1.13. Agjencia e Statistikave të Kosovës përzgjedh dhe cakton operatorët, personelin manxhues dhe ekspertët profesional e shkencor.

## **Neni 22 Financimi i regjistrimit**

1. Regjistrimi i Bujqësisë financohet nga dy burime:

1.1. Buxheti i Kosovës, dhe

1.2. Donatorët.

2. Llogaria e projektbuxhetit përgatitet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

3. Fondet e mbledhura nga donatorët, duhet të specifikohen me anë të marrëveshjeve të veçanta.

## **Neni 23 Ndalimi i mbledhjes së të dhënave të ngjashme**

1. Brenda periudhës prej tre (3) muajsh para kryerjes së Regjistrimit, gjatë kohës së mbledhjes së të dhënave dhe tre (3) muaj pasi të jetë kryer regjistrimi, ju ndalohe të gjithë individëve, organizatave vendore e ndërkombëtare të mbledhin të dhëna të ngjashme brenda territorit të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, nuk duhet të zhvillohet asnjë aktivitet tjetër statistikor në nivel vendor apo ndërkombëtar, i cili mund të ndikoj në regjistrim.

2. Entitetet të cilat gjatë periudhës sipas paragrafit 1. të këtij neni, synojnë të mbledhin të dhëna për individët dhe ekonomitë bujqësorë, për aktivitetet e tyre ekonomike, duhet të kërkojnë autorizim nga Komisioni i Regjistrimit të Bujqësisë.

## **KREU VII DISPOZITAT NDËSHKIMORE**

### **Neni 24 Kundërvajtjet**

1. Me gjobë prej pesëqind (500€) deri në njëmijë euro (1.000) Euro dënohet për kundërvajtje personi i angazhuar për regjistrim, për shkelje të rregullave, sipas nenit 21 të këtij ligji;

2. Me gjobë prej dyqind e pesëdhjetë (250) Euro deri në pesëqind euro (500) dënohet për kundërvajtje kreu i ekonomisë familjare bujqësore i cili refuzon të jap të dhënat e kërkuara nga regjistruesi apo nga personi tjetër i autorizuar për regjistrim sipas nenit 6 dhe nenit 9 të këtij ligji, apo i jep të dhëna jo të plota.

3. Me gjobë prej dymijë e pesëqind (2.500) deri në pesëmijë euro (5.000) Euro dënohet për kundërvajtje subjekti juridik ndërmarrës, i kooperativës bujqësore i formës tjetër të organizimit të angazhuar në prodhimtari bujqësore, nëse ai nuk ofron informacione ose nëse jep informacione të pasakta sipas nenit 6 dhe nenit 9 të këtij ligji;

4. Me gjobë prej njëmijë e pesëqind (1500) deri në dymijë (2000) Euro dënohet për kundërvajtje subjekti afarist i cili nuk e zbaton kriteret e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji;

5. Me gjobë në shumën prej dyqind e pesëdhjetë (250) deri në pesëqind euro (500) Euro dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës i personit juridik sipas paragrafit 3. të këtij neni.

6. Me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë euro (1000) Euro dënohet për kundërvajtje ndërmarrësi i përcaktuar në nenin 6 dhe nenin 9 të këtij ligji.

## **KREU VIII DISPOZITATA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 25**

Ministritë dhe institucionet përkatëse obligohen në afat prej tre (3) muajve të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

### **Neni 26**

Të gjitha të hyrat që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji derdhën në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Neni 27 Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L - 127  
13 dhjetor 2012**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-063-2012, datë 27.12.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga**